BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 3018 Prot.
Date 19.5.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË
KRYESEKRETARIA

Nr. 115/838 akti (E.Biba) **Lezhë, më dt.14.05.2026**

Lënda : Kërkesë për afishim shpallje të vendimit me nr. 157 (53-2026-559) datë 27.02.2026, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

NJESISE ADMINISTRATIVE PIRG

Adresa : Pirg, Bashkia Maliq

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është zhvilluar gjykimi i çështjes gjyqësore civile që i përket vendimi nr. 157 (53-2026-559) datë 27.02.2026, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
Referuar konfirmimeve të shërbimit postar rezulton se nuk është bërë i mundur njoftimi i vendimit të sipërcituar për palen ndergjyqese **Aida Hajder Blushi** dhe për këtë arsye është vendosur njoftimi i tij me anë të shpalljes publike.

Sa më sipër kërkojmë afishimin e shpalljes përkatëse në këndin e njoftimeve dhe konfirmimin e këtij veprimi me shkresë nga ana juaj duke ia drejtuar Kryesekretarisë së Gjykatës.

Bashkëngjitur kësaj shkrese por ju dërgojmë Shpalljen e datës 14.05.2026.

Ju faleminderit për mirëkuptimin !

KRYESEKRETARI GJYKATËS
Ilir Çuni

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

-Ky-A-Pirg
-STIMP
dt 19-05-2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË
KRYESEKRETARIA

Nr. 115/838 akti (E.Biba) **Lezhë, më dt.14.05.2026**

SHPALLJE

"Për komunikimin e vendimit gjyqësor civil"

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është gjykuar çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse :

Palë Paditëse: Aurel Gjovalin Blushi, me adresë Mamurras, Bashkia Kurbin

Palë e Paditur: **Aida Hajder Blushi, me adrese Pirg, Bashkia Maliq**

Me Objekt : Zgjidhje martese etj

Me vendimin nr. 157 (53-2026-559) datë 27.02.2026, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka vendosur :

1. Pranimin e padisë së palës paditëse Aurel Blushi.
2. Zgjidhjen e martesës ndërmjet paditësit Aurel Blushi dhe palës së paditur Aida Blushi.
3. Pas zgjidhjes së martesës pala paditëse Aurel Blushi të mbajë mbiemrin para martesës "Bunaj".
4. Një kopje e këtij vendimi pasi të marrë formë të prerë t'i dërgohet për regjistrim Zyrës së Gjendjes Civile 246, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.
5. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim ka qene i pamundur ti komunikohet **pales se paditur Aida Hajder Blushi.**

Gjykata për efekt njoftimi të këtij vendimi gjyqësor bazuar në nenin 133/a e 133/b të K.Pr.Civile nxjerr shpalljen për palën e paditur një kopje e së cilës afishohet pranë **Njesise Administrative Pirg**, një kopje pranë këndit të njoftimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, një kopje në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe një kopje administrohet në dosjen gjyqësore.

Ky njoftim do të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë.

Pas kësaj date pala e paditur **Aida Hajder Blushi** konsiderohet e njoftuar dhe të gjitha veprimet kryhen në mungesë të tij.

Kryesekretari i Gjykatës
Ilir ÇUNI

Shpallja publike u afishua në stendën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe u dërgua për afishim pranë Njesise Administrative Pirg me datë ___.05.2026 e cila ka detyrimin ligjor të konfirmojë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, realizimin e këtij afishimi

Punonjësi i gjykatës

Shpallja publike u afishua në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me datë __.05.2026.